

Rezyme e temës Master  
RACIZMI DHE INTOLERANCA NË MEDIAT E KOSOVËS

Nga  
Anda Maliqi

Mentori: Prof.Ass. Dr. Ibrahim Berisha

Liria e shprehjes është një ndër të drejtat më themelore të garantuara nga instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe vendore. Shumëllojshmëria e mediave në Kosovë si dhe zhvillimet e vazhdueshme teknologjike kanë mundësuar që gjuha e urrejtjes të ketë një përhapje të madhe.

Ky hulumtim synon të dekurajojë dhe të parandalojë gjuhën raciste duke demonstruar rrezikun që paraqet si edhe përmes kundërnarrativës, pra, duke ritheksuar vlerat që ajo kërcënon dhe duke sfiduar argumentet mbi të cilat bazohet. Duke pranuar që përdorimi i gjuhës racore duket në rritje, sidomos përmes sistemeve të komunikimit elektronik dhe nevojën që kjo situatë të korrigojë, hulumtimi është i një rëndësie të veçantë sepse synon luftimin e gjuhës së urrejtjes mbi shkaqet e “racës”.

Me një fokus në kënde të ndryshme të racizmit dhe efektet e tij mbi shoqërinë, hulumtimi sjell rëndësinë pse është thelbësore t’i jepet fund racizmit për të kontribuar në mirëqenien e njerëzimit dhe të punohet kolektivisht në rrugën për t’a çrrënjësuar plotësisht atë.

Metodologjia dhe metodat e përdorura në këtë hulumtim kanë qenë në përputhje me karakterin përkatës të studimit në fjalë. Së pari u fillua me konsultimin e materialeve të ndryshme shkencore, relevante me studimin tonë për t’i dhënë një kahje sa më të drejtë këtij studimi në mënyrë që të ishte sa më i mirëfilltë dhe i kuptueshëm.

Informatat e paraqitura në këtë hulumtim janë zhvilluar në regjionin e Anamoravës. Si metodë hulumtuese është përzgjedhur sondazhi me anë të shpërndarjes të anketave. Janë realizuar gjithsej 110 anketa, 50 në Komunën e Gjilanit, 30 në Komunën e Kamenicës dhe 30 në Komunën e Vitisë, me respodente të moshave 18-46 vjeç. Sondazhi shqyrton perceptimet e të rinjve lidhur me gjuhën raciste në vendin tonë. Përveç realizimit të anketave hulumtimi përmban edhe intervistat e gjysëm-strukturuara të cilat i kemi zhvilluar me përgjegjës, redaktorë të

mediave, sociologë dhe gazetarë, duke përfshirë edhe rekomandimet e tyre për eliminimin e racizmit dhe vetëdijësimin e qytetarëve për këtë fenomen.

Krejt në fund ky hulumtim na dërgon në përfundimin se ende ekzistojnë steteotipe e paragjykime për njerëzit me ngjyrë. Megjithë përparimet e arritura në trajtimin e barabartë dhe luftën kundër diskriminimit, sfidë e përgjithme mbetet trajtimi i personave si anëtarë më pak të vlefshëm në shoqëri.

Hulumtimi është strukturuar si më poshtë:

**Kapitulli I-** Hyrje, i cili jep një prezantim të përgjithshëm të fenomenit objekt studimi e cila shoqërohet me objektivat dhe rëndësinë e studimit.

**Kapitulli II-** Shqyrtimi i Literaturës, lexuesi njihet më shumë me thelbin dhe kuptimin e temës, duke u njoftuar nga studime të ndryshme nga hulumtues të huaj dhe vendor.

**Kapitulli III-** Kapitulli i tretë është kapitulli në të cilin është përshkruar metodologjia e punës dhe metoda e përdorur për realizimin e hulumtimit. Po në këtë kapitull, lexuesit informohen më shumë për pyetëtorin e përdorur në punën e terrenit, i cili është i përshkruar në mënyrë të detajuar.

**Kapitulli IV-** Rezultatet. Analizohen rezultatet e përfituara nga hulumtimi shkencor.

**Kapitulli V-** Kapitulli i pestë përmban sesionin e përfundimeve dhe rekomandimeve. Në këtë kapitull janë përmbledhur të gjitha përfundimet e arritura, nga analiza e rezultateve dhe janë dhënë disa rekomandime, të cilat ndihmojnë në organizimin më të mirë të punës.

**Kapitulli VI-** Bibliografia. Listohen burimet shkencore dhe të internetit nga është bazuar punimi.